**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

# DRAFT - RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR.01-110/01-0025382/22 PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA, E PLOTËSUAR DHE NDRYSHUAR ME RREGULLOREN PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA NR. 01-110/01-0031372/25 - KOMUNA SKENDERAJ

**Skenderaj, Prill 2026**

Në mbështetje të nenit 11 dhe 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja c), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Kreut II dhe Kreut III të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L -108 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, nenin 14, nenin 20, nenin 61 dhe 66 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: ____________ miraton këtë:

**DRAFT - RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR.01-110/01-0025382/22 PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA, E PLOTËSUAR DHE NDRYSHUAR ME RREGULLOREN PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA NR. 01-110/01-0031372/25.**

**Neni 1**
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Draft - Rregullore është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores Nr. 01-110/01-0025382/22, të datës 06.06.2022 Për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025, të Komunës së Skenderajt.

**Neni 2**

**1. Në nenin 11 ndryshohen dhe plotësohen paragrafët 11.5, 11.6 dhe 11.7, të cilët formulohen si në vijim:**

Neni 11

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

**11.5 Tarifat në Stacionin e Autobusëve:**

Çmimet për secilën hyrje në Stacionin e Autobusëve përcaktohen në bazë të relacioneve të autobusëve.

**11.6 Autobusët e relacionit ndër-urban:**

- Autobusët e relacionit Skenderaj – Prishtinë **3.5 €;**
- Autobusët e relacionit Skenderaj – Mitrovicë **2.5 €;**
- Autobusët e relacionit Skenderaj – Klinë **2 €.**

**11.7 Autobusët e relacionit urban dhe urban-periferik 2 €.**

**2. Në neni 11 hiqen paragrafët 11.8 dhe 11.9.**

## Neni 3

## Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi tridhjetë (30) pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe brenda shtatë (7) ditësh pas publikimit në web-faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.